



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:004539
Datë: 20.11.2024
Numri i dokumentit: 06481028

K.DH.Sh II.nr.1541/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha çështjen juridike përbarimore të kreditorit Dogana e Kosovës, me adresë Lagjja Kalabri, rruga “Rexhep Krasniqi” Nr.1, Prishtinë, kundër debitorit D.P.Z. “Lirimi”, me numër fiskal 600248232, me seli në fshatin K.M., Komuna e Rahovecit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Armend Krasniqi, avokat nga Prishtina, me bazë juridike përbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për çështje Ekonomike, KPPP.nr.1644/23 i datës 05.06.2024, me datën 20.11.2020, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e debitorit D.P.Z. “Lirimi”, me seli në fshatin K.M., Komuna e Rahovecit, ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës së parë- Departamenti për çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1644/23 i datës 05.06.2024, dhe Lënda i kthehet të njëjtës gjykatë, në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkalles se pare- Departamenti për çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, i paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përbarimit P.nr.723/19 të datës 05.09.2019, të Përbaruesit Privat Kushtrim Metaj.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Dhomat e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar, anuloj aktvendimin e atakuar dhe lenden të kthej në rigjykim në Dhomat e shkallës së parë.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, me datën 05.09.2019, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit D.P.Z. "Lirimi", me seli në fshatin K.M, Komuna e Rahovecit, në bazë të dokumentit të besueshëm- aktvendimit Nr. 03.1.1-2018-576/1 M.G.CS-0538 të datës 07.02.2019.

Përmbartuesi privat Kushtrim Metaj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.723/19 të datës 05.09.2019 e ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit të paguaj shumën prej 120,222.38€, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin e përmbartimit, duke theksuar se borxhi i paraqitur në vendim është inekzistent, për faktin se kreditori nuk i ka ofruar debitorit asnjë specifikacion se si ka ardhur deri te shuma prej 120,222.38€. Lidhur me këtë çështje është ushtruar padi pranë gjykatës kompetente ku është duke shqyrtuar ligjshmëria e këtij vendimi. I propozon gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitori dhe të anuloj urdhrin përmbartimor.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar në tërsi prapësimin e debitorit duke shtuar se aktvendimi i nxjerre në procedurë administrative është i ekzekutueshëm dhe i formës së prerë. Fakti i paraqitjes së padisë nuk e shtyn ekzekutimin e urdhrin, prandaj i propozon gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së parë- Departamenti për çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPP.nr. 1644/23 i dt.05.06.2024 e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, i paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.723/19, i datës 05.09.2019, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Kushtrim Metaj.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin në baze të nenit 21 dhe 22 të LPP-së, gjykata gjeti se dokumenti përmbarimor vendimi Nr. 03.1.1-2018-576/1 M.G.CS-0538 të datës 07.02.2019, të kreditorit, në bazë të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin është dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla, dhe i njëjti përmbarim të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 të LPP-së.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata Komerciale –Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk mund ta pranoj përfundimin dhe qëndrimin juridik të dhomës së shkallës së parë pasi që e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Dhoma e shkallës së dytë ka vendosur që ta kthej lëndën në rigjykim dhe rivendosje.

Nga shkresat e lëndës, kjo gjykatë vlerësoi se kreditori ka paraqitur propozimin për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbarimor nr.03.1.1-2018-576/1 MG CS-0538 datës 07.02.2019, dhe përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin me Urdhrin P.nr.723/19 datës 05.09.2019, mirëpo nga provat e lëndës, konstatohet se ky vendim përmbarimor, në procedurë të konfliktit administrativ është anuluar pjesërisht me aktgjykimin A.nr.1428/19 datës 20.05.2021 nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal, i vërtetuar nga Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, KDHSII.nr.1018/22 dt.05.09.2023 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ nr.26/24 dt.15.05.2024.

Nga këto prova që gjenden në lëndë, Gjykata vlerëson se Dhoma e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 22 të LPP-së, të cilën dispozitë e ka përdorë si bazë që të refuzohet prapësimi i debitorit i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit, kjo pasi që nuk janë dhënë vlerësime në përputhje me gjendjen faktike të shkresave të lëndës.

Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se vendimi përmbarimor respektivisht aktvendimi nr. 03.1.1-2018-576/1 M.G.CS-0538 të datës 07.02.2019 i nxjerr nga kreditori Dogana e Kosovës në Prishtinë, i cili është anuluar pjesërisht nga gjykata, tani nuk është titull ekzekutiv i vlefshëm për tu përmbaruar në bazë të nenit 22 të LPP-së.

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se arsyetimi i aktvendimit të atakuar është i përfshire me shkelje të nenit 182 par.2 pika (n) të LPK-së, sepse nuk janë vërtetuar faktet vendimtare sa i përket pretendimeve në prapësim të debitorit dhe shkresave të lëndës.

Në rigjykim, Dhoma e shkallës së parë e Gjykatës Komerciale, duhet të ketë parasysh të gjeturat e Dhomave të shkallës së dytë, të vlerësoj pretendimet në prapësim të debitorit dhe përgjigjes në prapësim të kreditorit, të konstatoj drejt ligjshmërinë e vendimit përmbarimor në bazë të cilit është iniciuar procedura përmbarimore, dhe në bazë të shkresave të lëndës, të vendos konform dispozitave ligjore duke marrë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Kompetenca e Dhomës së shkallës së dytë, për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë, bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika d) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.1541/24 me datë 20.11.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha